-

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission

Prishtinë/Priština, rr./ul. Migjeni p.n/b.b; tel. +381 (0) 38 211 337; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut

Lista Përfundimtare e Votuesve

2014

Qëllimi

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (ligji numër 03/L-073), neni 64.2. KQZ-ja është e obliguar që të *certifikoj listën e votuesve* në raport me zgjedhjet e caktuara. Ky dokument e mbështetë procesin e certifikimit të listës së votuesve.

Përmbledhje

Lista Përfundimtare e Votuesve **(LPV 2014)** për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetarë Komune në komunën e Mitrovicës së Veriut 2014 bazohet në Ekstraktin e Regjistrit Civil. Ky ekstrakt është përpiluar nga Agjencia e Regjistrimit Civil, gjegjësisht Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve (DPA), në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përshkrim lidhur me krijimin e Listës së Votuesve

Ekstrakti i parë të Regjistrit Civil

Pas pranimit të Ekstraktit të parë të Regjistrit Qendror Civil, Divizioni i Shërbimit të Votuesve para se të fillojë alokimin e votuesve në Qendra të Votimit ka bërë caktimin e votuesve të rinj në QV në mënyrë automatike dhe manuale (Votuesit e vjetër që kanë votuar në mënyrë të rregullt në Qendrat e tyre të votimit nuk janë prekur).

Sa i përket, ekstraktit të parë, në bazë të të cilit është krijuar Lista preliminare e Votuesve, e njëjta ka përmbajtur këto të dhëna:

1. Lista Preliminare e Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës Veriore 2014 përmban: **21 745 votues.**

2. Votuesit e rinj që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në komunën e Mitrovicës së veriut, që do të mbahen më 23 Shkurt 2014, janë: **927 votues,**

- **342** votues të rinj që pas Zgjedhjeve Lokale 2013 kanë arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe që do të votojnë për herë të parë në Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Komunën e Mitrovicës së veriut,

- **585** votues që nuk kanë qenë në Listën Përfundimtare të Votuesve 2013 për Komunën e Mitrovicës së Veriut, e që mund të konsiderohen si votues të regjistruar për herë të parë në Regjistrin Qendror Civil midis dy palë zgjedhjesh.

3. Emrat e personave të vdekur dhe qytetarët me të drejtë vote që kanë hequr dot nga shtetësia e Republikës së Kosovës, e të cilët kanë qenë në Listën e Votuesve 2013 e që nuk gjenden në Listën e Votuesve për Mitrovicën e Veriut 2014 janë: **102 votues,**

4. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me qëllim të informimit të votuesve të rinj, , përmes kartolinave do t'i njoftojë votuesit lidhur me qendrat e votimit ku ata janë caktuar. Numri total i votuesve që janë njoftuar përmes kartolinave është: **849** votues.

Pas pranimit të ekstraktit të dytë Regjistrit Qendror Civil, si pjesë të këtij ekstrakti, ka qenë e bashkangjitur në tabelë shtesë me 6 684 emrat të personave që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës.

Divizionit për Shërbim të Votuesve, lidhur me këta emra ka parashtruar kërkesë që për këtë cështje të dikutohet në Këshillin përkatës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe gjithashtu edhe në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, në lidhje marrjen e një vendimi për përfshirjen ose jo të këtyre emrave në Listën e Votuesve.

Andaj, lidhur me këtë, më poshtë gjeni përshkrimin profesional se kush ka të drejtë për përfshihet në Listën e Votuesve.

I. Në bazë të Rregullës Zgjedhore Nr. 02/ 2013 për Krijimin, Konfirmimin dhe Kundërshtimin e Listës së Votuesve, **në nenin 2.2** përcakton, se: Regjistri Qendror Civil do të thotë regjistri i banorëve të përhershëm, sipas Ligjit për Shtetësinë dhe sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Ndërsa, sipas **nenit 3** po të kësaj rregulle, lidhur me procesin e krijimit të Listës se Votuesve, gjegjësisht **neni 3.1 pika a** përcakton, se: KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë. Gjithashtu, në **nenin 3.4** të kësaj rregulle, ekstrakti i regjistrit qendror civil duhet të përmbajë të gjithë qytetarët e regjistruar të moshës 18 vjecare e mbi, duke përfshirë edhe ata që i mbushin 18 vjet deri në ditën e zgjedhjeve.

<u>Informatat personale që do të sigurohen për secilin qytetarë janë:</u>

a) Emri dhe mbiemri,
b) Data e lindjes së tij/ saj,
c) Emri i njërit prind,
d) Gjinia,
e) Emri i njërit prind,
f) Numri personal (Numri Personal i Identifikimit është shenjë e përhershme e identifikimit e çdo personi, është e dhëna unike, e cila lëshohet ose i epet qytetarit qysh me aktin e lindjes, gjithashtu kjo shifër unike epet edhe për ata qytetarë, të cilët aplikojnë për shtetësinë e Republikës së Kosovës, ku pastaj kjo reflektohet edhe në Ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil, me aktin e marrjes së dokumentit identifikues të Republikës së Kosovës)

g) Data e Regjistrimit Civil (është data ku qytetari aplikon për dokument identifikimi)
h) Komuna
i) Qendra Komunale e Regjistrimit Civil (është qendra ku qytetari aplikon për dokument identifikimi)
j) Kodi i Komunës,
k) Emri i Vendbanimit,
l) Adresa,
m) P-Kodi i vendbanimit (P-kod është një term shkurtesë për kodet e vendeve. Këto kode janë krijuar me qëllim të identifikimit të qyteteve, fshatrave/ vendbanimeve dhe njësive administrative. Këto kode janë krijuar qysh në vitin 2000 nga OSBE-ja e të cilat janë përdorur për regjistrimin civil dhe për nevoja të Zgjedhjeve, gjegjësisht më këto kode mundësohet caktimi i votuesve nëpër qendra të Votimit), dhe
n) UD Kodi i vendbanimit (është i njëjtë sikur P – kodi, por shërben vetëm për qendrat e mdhaja brenda qytetit).

<u>Të dhënat që përmban Regjistri Qendror Civil:</u>

Numrin Personal të Identifikimit, Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil, Datën e Regjistrimit, Mbiemrin, Emrin, Emrin e Babait, Datën e Lindjes, Gjininë, Rrugën, Adresën, Komunën, Kodin Komunal dhe P-Kodin dhe UD Kodin.

<u>Të dhënat që përmban tabela me emrat e 6 684 personave, që janë si në tabelën, e cila është e bashkangjitur si pjesë e veçantë në Ekstraktin e RQC-së:</u>

a) PIN Kodi,

b) Kodi trembëdhjetë shifror (i ashtuquajtur JMBG),

c) Emri,

d) Mbiemri,

e) Emri i prindit,

f) Data e Lindjes,

g) Vendbanimi,

h) Komuna,

i) Numri i rrugës,

j) Numri i shtëpisë/ apartamentit,

Bazuar në të gjitha këto, respektivisht në dallimin e të dhënave midis Regjistrit Civil dhe kësaj liste të bashkëngjitur, por edhe bazën ligjore për të drejtën e votës në Kosovë, vlerësimi ynë është se kjo listë me këta 7000 emra nuk është e sigurt dhe e qartë që i plotësojnë kriteret për të pasur të drejtë vote në Kosovë.

Në lidhje me listën e votuesve në bazë të Ligjit mbi zgjedhjet e përgjithshme për përmbajtjen e Listës së Votuesve, në bazë të nenit 7.1 përcaktohet se KQZ-ja mban Listën e Votuesve dhe siguron që Lista e Votuesve është e saktë dhe e azhuruar, dhe e njëjta përmban:

a) ekstraktin më të vonë në dispozicion nga Regjistri Qendror Civil i të gjithë votuesve me të drejtë vote të cilët janë regjistruar si qytetar të Kosovës sipas Ligjit për Shtetësinë;

Ndërsa, neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë se; çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësorë. Ndërkaq sipas Ligjit për Shtetësinë e Kosovës, nenit 29 Shtetësia e Republikës së Kosovës dëshmohet me certifikatën e lindjes, ekstraktin e lindjes, certifikatën e shtetësisë, letërnjoftimin ose me pasaportën e Republikës së Kosovës.

Periudha e shërbimit të votuesve

Të gjithë votuesit kanë pasur mundësi që t'i vizitojnë zyrat e Komisioneve Komunale Zgjedhore (nga data 25 Janar 2014 deri me datën 7 Shkurt 2014) për t'u informuar se në cilën qendër të votimit janë caktuar ose të kërkojnë ri-caktim të qendrës së votimit më të përshtatshme për ta.

Gjatë kësaj periudhe njëmbëdhjetë votues kanë parashtruar kërkesë për ndërrim të Qendrave të Votimit në zyrat e KKZ-ve.

Votuesit vazhdimisht kanë pasur mundësi të konfirmojnë qendrën e tyre të votimit në ueb faqen e KQZ-së. Gjatë kësaj periudhe makinën kërkuese e kanë vizituar 2192 vizitorë.

Pas kësaj periudhe, Divizioni i shërbim të votuesve ka vendosur të gjitha ndryshimet në listën e votuesve, e cila më pas është integruar në ekstraktin e pranuar nga Agjencia e Regjistrimit Civil/ Departamenti i Prodhimit të Dokumenteve.

Periudha e Sfidimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve

Në bazë të Planit Operacional të Zgjedhjeve, Periudha e Sfidimit dhe Kundërshtimit të Listës së Votuesve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar Komune në Mitrovicën e Veriut, është zhvilluar nga data 3 Shkurt 2014 deri me datën 7 Shkurt 2014. Gjatë kësaj Periudhe, nuk ka patur asnjë kërkesës që ka të bëjë me sfidimin dhe kundërshtimin e LV-së në gjykatën e shkallës së parë. Pasi që Divizioni i Shërbimit të Votuesve ka pranuar shkresën nga Këshilli Gjyqësorë me listën e emrave të personave që u është marrë zotësia e veprimit, ka bërë analizimin e tyre.

Krijimi i LPV-së

Pas përfundimit të Periudhës së Shërbimit të Votuesve, Zyra për Shërbim të Votuesve i ka klasifikuar votuesit nëpër QV, si dhe i ka ndarë në vendvotime sipas alfabetit. Të dhënat e reja janë shtypur në format PDF dhe kualiteti është kontrolluar nga ana e Divizionit të Shërbim të Votuesve. Këto dokumente janë të gatshme për t'ju dërguar kompanisë e cila do ta bëj shtypjen përfundimtare të LPV-së 2014.

Votimi përmes Postës

Programi i votimit me Postë është ndërmarrë në mes datës 24 Janar 2014 dhe 2 Shkurt 2014. Divizioni i Shërbimit të votuesve ka dërguar shtatëmbëshjetë aplikacione për regjistrim votuesve që në zgjedhjet e kaluara kishin arritur të dëshmonin kriteret e zotësisë juridike për të votuar. Deri në përfundim të periudhës së regjistrimit kemi nuk kemi pranuar asnjë aplikacion për regjistrim.

Rekomandimet për Agjencinë e Regjistrimit Civil/ Regjistrit Qendror Civil

Divizioni i Shërbimit të Votuesve vlerëson bashkëpunimin e ngushtë dhe profesional me Agjencinë e Regjistrimit Civil. Lidhur me proceset e ardhshme të krijimit të Listës së votuesve, Divizioni i Shërbimit të Votuesve ofron këto rekomandime:

- Për shkak të pasaktësisë së adresave, gjë që na ka paraqitur problem në caktimin adekuat të votuesve nëpër Qendra të Votimit, rekomandojmë që sa më parë të integrohet sistemi unik i adresave në bazën e të dhënave për të gjithë votuesit,

Përmbledhje:

1. **Numri i votuesve për Komunën e Mitrovicës së Veriut, Numri i Qendrave të Votimit dhe Vendvotime.**

Komuna	Numri i Votuesve	Nr. i Qendrave të Votimit	Nr. i Vendvotimeve
38 - Mitrovica e Veriut	21 745 Ekstrakti i RQC-së	7	33
	6684 Tabela Shtesë		

Bashkangjitur me këtë dokument, gjeni shembuj lidhur me të dhënat se si janë të pasqyruar në Ekstraktin e Regjistrit Qendror Civil dhe të dhënat që përmban tabela shtesë me 6 684 emrat të personave.